



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:044690

Datë: 18.09.2024

Numri i dokumentit: 06179028

Ac.nr.1049/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.B.F., nga Gjilani, të cilën e përfaqëson me autorizim K.A.-S. avokate në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson B.M., zyrtar ligjor tek e paditura, me objekt të kontestit kompensimin i shpërblimit jubilar, kompensim i ushqimit gjatë punës dhe udhëtimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.774/20 të datës 15.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 18.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.774/20 i datës 15.12.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin e atakuar C.nr.774/20 të datës 15.12.2021, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Sh.B.F., dhe ka obliguar të paditurën që paditëses në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të 50% të një page bazë t’ia paguaj shumën prej 210.50 euro, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 11.03.2020, për 600 ditë pune shumën prej 1,200 euro, dhe në emër të shpenzimeve për udhëtim për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 11.03.2020, për 600 ditë pune t’ia paguaj shumën prej 420 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,830.50 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë (07.04.2020), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7(shtatë)ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II, ka detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 270.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar kurse aktgjykimin C.nr.774/20 të datës 15.12.2021, ta prish duke e refuzuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë apo të njëjtin ta prish dhe çështja të kthehet rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar e autorizuar e paditëses duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit, ta refuzoj si të pabazuar ankesën e të paditurës ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, C.nr.774/20 të datës 15.12.2021, ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarës së saj, me datë 07.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, të cilën e ka precizuar në seancën e datës 15.12.2021, për kompensimin e shpërblyerit jubilar, kompensimin e ushqimit gjatë punës (shujtave), si dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.774/20 të datës 15.12.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse, sikur që nuk kanë qenë kontestuese pothuajse të gjitha provat e prezantuara nga paditësja andaj edhe e njëjti e ka bërë të besueshme dhe të themeltë kërkesëpadinë e saj. Tutje, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se baza juridike e padisë ka rezultuar të jetë e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, me anë të së cilës në mes tjerash punëdhënësi, sipas nenit 35 par.5, 7 dhe par.8 të Kontratës, obligohet që punëmarrësve tu sigurojë shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e ushqimit, për këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditëses t'i kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimit. Vendimin për kamatëvonesë, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e marrjes

së aktgjykimit e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 449, 452 dhe 463 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk është kontestuese në mes palëve se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse në Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Thimi Mitko” në Gjiilan, ndërsa nga provat e bashkangjitura është vërtetuar se paditësja jeton në fshatin P., Komuna e Gjiilanit, fakt i cili vërtetohet me anë të certifikatës së vendbanimit dhe se e njëjta udhëton për në vendin e punës, ndërsa sipas vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportuesve të Udhëtarëve “Anamorava”, në Gjiilan, është vërtetuar fakti se bileta njëdrejtimeshe P.-Gjiilan ka vlerën 0.50 euro, ndërsa vajtje – ardhje vlerën prej 1.00 euro. Po ashtu në bazë të vërtetimit të datës 11.06.2020, të lëshuar nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Thimi Mitko” në Gjiilan, është vërtetuar së paditësja për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datë 11.03.2020, ka 600 ditë prezentë në punë, dhe e njëjta ka 12 vite përvojë punë, dhe ka pagën bazë 421.00 euro, fakt i vërtetuar në bazë të listës së pagave Buxheti i Republikës së Kosovës të datës 26.09.2019.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo pasi që në bazë të nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se “...*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punon i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”. Duke marrë parasysh se nga provat e administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është vërtetuar së paditësja është me vendbanim në fshatin P., Komuna e Gjiilanit, dhe e njëjta udhëtonë për në vendin e punës, për të cilin është vërtetuar edhe çmimi i biletave një dhe dy drejtimesh nga vendbanimi i saj për në Gjiilan, andaj bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata e Apelit, vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit. Po ashtu gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale edhe sa i përket vendosjes lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, kjo

pasi që bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është paraparë së “*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*”. Ndërsa në bazë të nenit 35 paragrafi 8, pika 8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë së “*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë*”. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar del se paditësja ka realizuar ditët e punës siç janë të theksua më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuara nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Thimi Mitko” në Gjilan, dhe po ashtu sipas listës së pagave Buxheti i Republikës së Kosovës të datës 26.09.2019, rezulton së paditësja ka 12 vite përvojë punë, çka nënkupton së 10 vite të përvojës së punës i ka arritur në vitin 2017, andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke ia njohur shumat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë dhe për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punës në lartësi prej 50 % të një page bazë, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit së e paditura nuk ka obligim ndaj paditëses pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 90 paragraf 1 të Ligjit NR.03/L-212 të Punës është paraparë se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes*”. Ndërsa në bazë të nenit 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK, është paraparë se: “*Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës*”. Duke qenë së e paditura në këtë rast është punëdhënëse e paditëses, Gjykata e Apelit vlerëson së e njëjta ka për obligim që t’ia bëjë kompensimin e shpërblimit jubilar, dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për ditët e pranisë në punë, ndërsa koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave, që buron nga Kontrata Kolektive, është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditëses dhe detyrimin e të paditurës.

Lidhur me pretendimin së kërkesa e paditëses është vjetërsuar bazuar në nenin 78 par.1 të Ligjit të Punës, Gjykata e Apelit gjeti së ky pretendim nuk qëndron, pasi që kërkesëpadia e paditëses

nuk është përfshirë në parashkrim, për faktin paditësja me datën 07.04.2020, ka paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e pagës jubilarë, kompensimin e ushqimit dhe të udhëtimit, për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, nga çka rezulton se nga fillimi i periudhën për të cilën kërkohet kompensimi e deri te paraqitja e padisë nuk kanë kaluar më shumë se tri vite, në mënyrë që të konsiderohet së kërkesa e paditëses është parashkruar ashtu siç përcaktohet me nenin 87 të Ligjit të Punës.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së, e po ashtu edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS–PRISHTINË

Ac.nr.1049/2022, datë 18.09.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci